

VENDIM
Nr.268, datë 4.5.2007

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, DISA BASHKIVE, TË PRONAVE, TË CILAT JANË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60,
DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 42 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të neneve 4, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme, publike, të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të miratuara me vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

a) Objekti me numër rendor 12, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Qendra e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, Shkodër, të kalojë në pronësi të bashkisë së Shkodrës.

b) Objekti me numër rendor 18, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Qendra e shërbimeve për të moshuarit”, Kavajë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Kavajës.

c) Objekti me numër rendor 21, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Qendra e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, Berat, të kalojë në pronësi të bashkisë së Beratit.

ç) Objekti me numër rendor 30, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Qendra e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, Korçë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Korçës.

d) Objekti me numër rendor 32, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Qendra ditore e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, Korçë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Korçës.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave shtetërore.

3. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi dhe shërbimi shoqëror, që ofrohet në to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin, personelin dhe dokumentacionin përkatës.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e grupit 25, titulli 10 430, kap.1, artikujt 600, 601 dhe 602, të buxhetit të vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe, në vijim, sipas vitit buxhetor përkatës.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetarët e bashkive të përmendura në pikën 1 dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha